



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 58
Prishtinë, më 14.09.2012, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 10.07.2012;**
- 3. Diskutim rreth projektit për themelimin e Komisionerit për Siguri;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 10.07.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 10.07.2012, i cili u miratua pa ndryshime.

3. Diskutim rreth projektit për themelimin e Komisionerit për Siguri.

Kryetari i Komisionit- Për projektin e themelimit të Komisionerit për sigurisë, tha se është iniciative e kahershme për themelimin e institucionit i cili do të mbron të drejtat e forcave ushtarake dhe përmendi shembullin e Gjermanisë, Bosnje e Hercegovinës dhe vendeve skandinave.

Tutje njoftoi se nga takimi i cili është organizuar në bashkëpunim me GIZ, është rënë dakord që në parim të krijohet institucioni i Komisionerit për segmentet e sigurisë në Kosovë, konkretisht për FSK-në dhe Policinë e Kosovës. Për këtë çështje me grupin është rënë dakord komunikimi me Ministrin e MPB-së dhe Ministrin e FSK-së dhe për këtë gjë kërkoi mendimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit, pasi me datë 19 tetor bëhet themelimi i grupit punues i cili do të hartoj projektligjin për Komisionerin e Sigurisë për Kosovën.

Tutje shtoi se Komisioneri për Siguri do të jetë institucion që mbron të drejtat e pjesëtarëve të FSK-së dhe Policisë së Kosovës si dhe do të themelohet nga Kuvendi i Kosovës dhe në këtë mënyrë mbikëqyrje ndaj institucioneve të sigurisë të bëhet duke mos ndikuar në çështjet e brendshme të tyre.

Rexhep Selimi- Për çështjen e Komisionerit për Sigurisë, ai tha se duhet ti zgjidhim disa dilema gjatë punës dhe kërkoi përkrahjen e Komisionit për grupin punues që do të merret me këtë çështje, në mënyrë që Komisioneri të mbuloj jo vetëm pjesën e ushtrisë por edhe atë të policisë, e cila gjë do të argumentohet nga grupi punues. Tutje ai tha se modeli i tillë është funksional për specifikat e Kosovës, dhe se grupi punues ka rënë dakord në parim, që Komisioneri për Siguri të mbuloj mbrojtjen e të drejtave të ushtarakëve dhe policisë.

Tutje ai shtoi se marrë në konsideratë numrin jo shumë të madhe të pjesëtarëve të FSK-së dhe të Policisë së Kosovës, do të jetë e lehtë përballimi i intensitetit të punës, për këtë arsye ai tha se grupi punues ka nevojë për mbështetjen e Komisionit, pasi kjo do të determinonte formimin e këtij institucioni. Gjithashtu ai tha se për themelimin e këtij institucioni është diskutuar mes anëtarëve të grupit punues, nëse ky institucion përpunet me infrastrukturën ligjore në Kosovë dhe koston buxhetore, deri tek fillimi i hartimit të projektligjit.

Fatmir Xhelili- Për themelimin e institucionit të Komisionerit, ai tha se pajtohet me z. Rexhep Selimi, duke theksuar se nuk është vlerësuar që ka ndonjë shkelje të drejtave të njeriut në institucionet e sigurisë, por ky institucion do të ishte në drejtim të parandalimit

të shkeljeve të tilla, gjithashtu vlerësoi se do të ishte mirë për shtetin që për dy strukturat, atë të policisë dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës, të ekzistonte një instrument që i mbulon dhe se për të gjitha ato çfarë u tha sot do të definohen në grupin punues për Komisionerin për Siguri.

Goran Marinković- Për themelimin e institucionit të Komisionerit për Siguri, ai tha se e përkrah iniciativën e grupit punues për themelimin e këtij institucioni për mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të FSK-së dhe Policisë së Kosovës. Tutje ai tha se institucione të tilla kanë vende të ndryshme dhe se përvojat e tyre duhet të shfrytëzohen në këtë drejtim dhe mënyrat e organizimit të këtij institucioni, gjithashtu ai tha se duhet shikuar mundësia financiare për implementimin e këtij projekti.

Për përfaqësimin e komunitetit serb në këtë institucion, ai tha se për demokracinë e reja siç është Kosova është e rëndësishme ky përfaqësim dhe propozoi që vendi i Komisionerit të ardhshëm të jetë i rezervuar për komunitetin serb, ndërsa për mënyrën e zgjedhjes së Komisionerit tha se duhet të zgjidhet nga Kuvendi, pasi në disa vende emërimi i tij bëhet nga Ministri përkatës, dhe se zgjedhja nga Kuvendi do të garantonte një pavarësi të këtij institucioni.

Kryetari i Komisionit- Për këtë iniciativë, ai tha se do të shikohen dy elementet të cilat do të favorizonin ose do të pengonin, fjala është për ligjet në fuqi, Ligji i Policisë së Kosovës, kostoja e implementimit e cila do të përcaktohet nga Ministria e Financave, prandaj konsideroi se duhet takuar me Ministrin e FSK-së, Ministrinë Punëve të Brendshme dhe Ministrin e Financave. Tutje tha se propozimi për përfshirjen edhe të Policisë së Kosovës në kuadër të Komisionerit për Siguri është bërë pasi numri i pjesëtarëve të FSK-së është i vogël dhe se në polici në disa raste janë evidentuar disa shkelje të drejtave të njeriut, ndërsa në FSK nuk janë paraqitur raste të tilla dhe se kjo do të jetë angazhim i përbashkët me Ministrinë për nxjerrjen e një ligji të tillë.

Fatmir Xhelili- Për institucionin e Komisionerit për Siguri, ai tha se qëllimi i krijimit të këtij institucioni është në drejtim të parandalimit të shkeljeve të mundshme të drejtave të njeriut për pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës, si dhe krijimi i një adrese të re ku mund të drejtohen këta pjesëtarët në rast të shkeljes së të drejtave individuale. Tutje shtoi se grupi punues që do të merret me këtë çështje do të përcakton formën për dhënien e kompetencave për Komisionerin për Siguri, për trajtimin e rasteve dhe problematikave.

Në vazhdim ai vlerësoi se në raport me numrin e pjesëtarëve që e përbëjnë FSK-në dhe Policinë e Kosovës, Komisioneri për Siguri mund ti mbulojë trajtimin e ankesave të mundshme, ndërsa për përkatësinë etnike të Komisionerit të ardhshëm, ai tha se nuk mund të përcaktohet apriori, pasi përzgjedhja e tij do të bëhet nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa përzgjedhja e stafit do të bëhet me konkurse.

Tutje ai vlerësoi se me krijimin e këtij institucioni, zyrtarët e FSK-së dhe të Policisë së Kosovës do të përfitojnë në rastet e shkeljeve të drejtave të tyre, ndërsa instancat për ankesa në strukturat ekzistuese, siç janë Komisionet Disiplinore, Komisioni për Ankesa, Inspektorati, në disa raste kanë anashkaluar, me dashje apo pa dashje trajtimin e ankesave dhe se Komisioneri do të jetë adresa e fundit për trajtimin e atyre ankesave. Gjithashtu theksoi se në grupin punues do të kushtohet rëndësi që gjatë hartimit të ligjit për Komisionerin për Siguri të mos bie në kolizion me ligjet e tjera në fuqi.

Anton Quni- Nga takimi i parë me grupin punues, ai tha se është rënë dakord që Komisioneri për Siguri të jetë adresë për të dy komponentët e sigurisë, FSK-së dhe Policisë së Kosovës. Për themelimin e këtij institucioni tha se nga mungesa e një përvoje të tilla ka dilema, por vlerësoi përkrahjen e autoriteteve të shtetit Gjerman për këtë çështje, për këtë arsye ai vlerësoi se do të propozohen disa alternativa duke e zgjedhur më të mirën.

Tutje konsideroi se grupi punues në përbërje të tij të ketë, anëtarët e Komisionit, përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Ministrisë së FSK-së, FSK-së dhe ekspert të ndryshëm, ai konsideroi se do të arrihet në krijimin e një mekanizmi funksional për nevojat e policisë dhe FSK-së.

Kryetari i Komisionit- Për përbërjen e grupit punues që do të punoj për projektligjin për Komisioneri për Siguri, tha se duhet të përcaktohen pjesëmarrësit, dhe vlerësoi se është e nevojshme pjesëmarrja e tre anëtarëve të Komisionit, nga një përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës si dhe nga një përfaqësues nga Ministria e FSK-së dhe FSK-ja, si dhe ekspert të jashtëm, siç është GIZ-i, si dhe vlerësoi nevojën e angazhimit të ndonjë eksperti nga ana e Komisionit, për të kontribuar gjatë hartimit të ligjit, për të cilën gjë ai tha se i është kërkuar përmes administratës, Sekretarit të Kuvendit për lejimin e angazhimit të ndonjë eksperti për hartimin e projektligjit.

Tutje pyeti anëtarët e Komisionit nëse janë dakord me përbërjen e propozuar për hartimin e projektligjit për Komisionerin e Sigurisë?

Fatmir Xhelili- Për përbërjen e grupit punues për Komisionerin e Sigurisë, ai tha se përbërja duhet lënë në kompetencë të procedurave për përbërjen e grupeve punuese që bëjnë hartimin e ligjit, pasi në përbërje të këtij grupi duhet të jenë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Zyrës së Kryeministrit, ministritë aktuale për të cilat krijohet ligji, prandaj konsideroi se për përbërjen e këtij grupi nuk mund të përcaktohem sot.

Kryetari i Komisionit- Për përbërjen e grupit punues për Komisionerin e Sigurisë, tha se pajtohet me propozimin e z. Xhelili, që çështja e përbërjes së grupit punues të jetë e hapur në mënyrë që në të përfshihen ministritë përkatëse ose Zyra e Kryeministrit, ndërsa theksoi se përbërja e këtij grupi do të bëhet me 19 shtator në takimin e themelimit të grupit punues.

Rexhep Selimi- Për përbërjen e grupit punues për Komisionerin ai tha se edhe Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës e dikton përbërjen e një grupi punues për hartimin e një ligji, që mund të jenë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave apo Zyrës së Kryeministrit, duke e plotësuar me anëtarët e Komisionit, prandaj konsideroi që sa më shpejt të informohen institucionet që duhet të përfaqësohen në këtë grup punues për të vazhduar punën tutje.

Kryetari i Komisionit- Në vazhdim të diskutimit tha se për përbërjen e grupit punues për Komisionerin e Sigurisë, biem dakord që të konstituohet me përbërjen që u tha me mundësinë që në të përfshihen përfaqësuesit e ministrive që duhet të përfaqësohen.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Njoftoi se në kuadër të mbikëqyrjes së institucioneve të sigurisë, nga OSCE është ofruar mbështetja profesionale nga z. Jan Perkins, ekspert i fushës , i cili është angazhuar në kuadër të mbikëqyrjes financiare të institucioneve të sigurisë dhe shpenzimeve të parasë publike dhe fjalën ia kaloi z. Perkins.

Ian Perkins(ekspert nga OSCE)- Për mbikëqyrjen financiare ndaj institucioneve të sigurisë, ai propozoi një mbikëqyrje të shkurtër nga afati kohor, duke përzgjedhur një dikaster më të ngushtë. Tutje ai theksoi se në disa komisione janë ngritur çështje nëse në kuadër të kësaj mbikëqyrje mund të bëhet mbikëqyrja e dyfishtë, mos po bëhet puna e Auditorit të përgjithshëm , apo punën e Komisionit për buxhet dhe financa ose Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike.

Në kuadër të kësaj mbikëqyrje mund të shfrytëzohen burime të ndryshme në kërkimin e dokumenteve financiare dhe me që është zgjedhur Policia e Kosovës, ai propozoi që të bëhet kërkesë për dokumente të tilla dhe theksoi burimet të jashtme që mund të përdoren, siç është hulumtimi i GAP-it për Policinë e Kosovës.

Në kuadër të mbikëqyrjes financiare ai propozoi se në vend të Ministrit të Punëve të Brendshme, do të ishte më mirë që për dëgjim publik të ftohet ndonjë udhëheqës i nivelit menaxheria i cili i njeh çështjet praktikisht dhe në fund të procesit një raport me rekomandime solide do të duhet të dilte nga ky proces, rekomandimet mund të përfshijnë aspektin e rritjes së efikasitetit në disa sfera, gjithashtu vlerësoi se mund të bëhet rekomandim që në vend të prokurimit të njëpasnjëshëm të bëhet në mënyrë të qëndrueshme dhe se rekomandimet e bëra do të bëhen në aspektin pozitiv.

Tutje ai tha se nga ftesa e cila i është dërguar për bashkëpunim, janë paraqitur disa data në bazë të cilave do të procedohet tutje, ndërsa hapi i parë që duhet bërë është përcaktimi i dikasterit që do të mbikëqyrret, ndërsa hapi dytë është kërkimi i dokumenteve nga dikasteri i caktuar ku bashkë me grupin punues do të shqyrtohen dokumentet dhe më pas të jepen rekomandime fillestare.

Në vazhdim ai vlerësoi se procesi i mbikëqyrjes financiare përfshin edhe kërkesën e dokumentacioneve shtesë, pastaj shqyrtimin e tyre dhe përgatitja e pyetjeve të cilat do të bëhen zyrtarit që do të ftohet në dëgjim publik dhe pas shqyrtimit të dëgjimit publik, grupi punues do të mblidhet dhe do të shqyrtoj dhe do të bëjë një raport i cili do të paraqitet para Komisionit dhe pas aprovimit nga ana e Komisionit, do të jetë i gatshëm.

Fatmir Xhelili- Për procesin e mbikëqyrjes financiare nga ana e Komisionit dhe për procedurat e prezantuara nga ana e ekspertit të OSCE-së, ai tha se pajtohet duke theksuar se përvoja e Komisionit për mbikëqyrjen financiare është e mangët. Tutje ai shtoi që Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, mbulon dy Ministri të cilat në kuadër të tyre kanë disa agjencione për të cilat janë disa vija buxhetore, të cilat ndahen për investime kapitale, për mallra dhe shërbime.

Për punën që duhet bërë nga grupi punues për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë, bëri pyetjen si në vijim.

A do të kishte kapacitet grupi punues për mbikëqyrjen financiare, që gjatë këtij procesi të shkohet me dy njësi buxhetore, duke mos mbetur vetëm me një njësi gjatë mbikëqyrjes?

Ian Perkins(ekspert nga OSCE)- Tha se mund të kërkohen më shumë vija buxhetore dhe preferon një gjë të tillë, ndërsa për dokumentet që do të kërkohen nga Policia e Kosovës, në to mund të përfshihen më shumë vija buxhetore dhe se për analizën e tyre duhet kohën e nevojshme ndërsa nga ana e grupit punues. Tutje ai tha se në funksion të punës së Komisionit, ka kontaktuar Agjencinë për Prokurim Publik dhe Auditorin e Përgjithshëm dhe është rënë dakord që nga ana e tyre mund të ofrohet ekspertizë.

Kryetari i Komisionit- Vlerësoi se pas krijimit të grupit punues që do të merret me këtë çështje, do të kërkohen dokumentet për tre vitet e fundit, të jetë i vlefshëm në bazë të analizave që i janë bërë nga zyra e prokurimit. Tutje propozoi që grupi punues për mbikëqyrjen financiare të realizoj një takim të veçantë me z. Perkins, për përcaktimin e llojit të dokumenteve që duhet shikuar për realizimin e mbikëqyrjes financiare, e cila nuk do të ndërhynte në çështjet e mekanizmave të tjerë që bëjnë kontrollin financiar ndaj këtyre institucioneve.

Fatmir Xhelili- Për punën e grupit punues për mbikëqyrjen e FSK-së, ai propozoi që me 21.09.2012, të realizohet takimi i grupit punues bashkë me ekspertin nga OSCE-ja

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se grupi punues për mbikëqyrjen financiare, të takohet në datën e propozuar nga Kryesuesi i grupit punues, për të parë mënyrën se si të procedohet për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë.

Luanda Domi(zyrtare e projektit të DCAF)- Njoftoi për ndryshimin e datës për vizitën studimore që do të realizoj Komisioni në Austri, kjo pasi Akademia e Mbrojtjes në Vjenë për shkak të aktiviteteve të shumta dhe ka propozuar datën 10-13 dhjetor 2012. Tutje njoftoi se temat që do të përfshihen në këtë vizitë studimore do të jenë, koordinimi i raporteve mes Komisionit parlamentar dhe institucioneve të sigurisë dhe koordinimi i sektorit të sigurisë në nivelin nacional.

Kryetari i Komisionit- Për vizitën studimore në Vjenë, ai tha se në emër të Komisionit e vlerëson të dobishme pjesëmarrja në të dhe se data e propozuar 10-13 dhjetor 2012 është e përshtatshme dhe se temat që mund të përfshihen në këtë vizitë duhet të identifikohen, në mënyrë që të kontribuohet në këtë vizitë studimore.

Gorna Marinković- Si nënkryetar i dytë i Komisionit tha se është i kënaqur me punën e Komisionit dhe bashkëpunimin mes anëtarëve dhe se asnjë deklaratë e tij nuk është kundër askujt në Komision. Tutje ai theksoi se si përfaqësues i komunitetit serb e sheh të nevojshme paraqitjen e disa problemeve që janë paraqitur në kufirin Kosovë-Serbi në Merdare.

Gjithashtu theksoi se nga bisedimet Kosovë-Serbi kanë rrjedhur disa konkluzione të cilat kanë qenë të dëm të qytetarëve serb që jetojnë në Kosovë dhe ata që janë të shpërngulur, dhe se gjatë lëvizja së qytetarëve në kufi paraqiten probleme, kjo pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, ku disa qytetar serb keqtrajtohen në kufi. Tutje ai tha se si përfaqësues i këtij komuniteti e paraqet këtë shqetësim, pasi vlerësoi se në kufi duhet të jenë njerëz profesionist dhe se për këtë qëllim duhet të ndërmerren masa. Për

këtë arsye propozoi që nga Komisioni të kërkohet sqarim për një situatë të tillë dhe shkelësit e rregullave.

Kryetari i Komisionit- Për çështjen e ngritur nga z. Marinkovič lidhur me sjelljen e policisë, ai tha se ankesat e qytetarëve duhet të drejtohen Inspektoratit Policor të Kosovës, që merret me një problematikë të tillë dhe se ky institucion mbikëqyret nga Komisioni dhe se mund të mbikëqyrë masat e marra nga ana e tyre për zyrtarin policor.

Rexhep Selimi- Për raportin e policisë me qytetarët, ai tha se këtë çështje e ka ngritur edhe në Kuvend dhe se Policia e Kosovës nuk do të duhej të ishte adresa e parë e sulmit, pasi kontributi i përbashkët do të shërbente pozitivisht që për policinë mos të bëhen adresime të tilla. Tutje shtoi se komuniteti duhet të bashkëpunoj me policinë dhe se pajtohet me z. Isufi, që në rast të problemeve të qytetarëve me policinë janë organet kompetente që merren me këtë çështje siç është IPK-ja. Ndërsa për z. Goran Marinkovič si anëtar i Komisionit do të jetë e mundur të shikoj procesin se si do të veprohet nga ana e tyre.

Tutje ai shtoi se çështjen e bashkëpunimit mes komunitetit serb dhe policisë nuk e konsideron si të kënaqshme edhe pse në kuadër të policisë ka përfaqësues nga ky komunitet. Prandaj konsideroi se bashkëpunimi është i domosdoshëm duke i shmangur akuzat apriori, gjithashtu përmendi rastin e kritikës që i është bërë nga ana e tij z. Petar Militič, i cili nuk po bën punën e duhur për bashkëpunimin e komunitetit serb me Policinë e Kosovës.

Goran Marinkovič- Për punën e Policisë së Kosovës ai tha se, ndërtimi i besimit mes qytetarëve dhe policisë konsiston në një komunikim normal dhe theksoi komunën e Graçanicës ku qytetarët bashkëpunojnë me policinë, gjithashtu theksoi disa aktivitete që bëhen nga ana e policisë për çështjet e sigurisë dhe se qytetarët e konsiderojnë si të tyre policinë dhe nuk pajtohet se nuk bashkëpunojnë. Tutje ai përmendi një rast, në të cilin ka qenë prezent, në të cilin një qytetar serb për paraqitjen e kërkesës për pajisje me patentë shofer në Prishtinë, pasi në Graçanicë nuk ekziston zyrë e tillë.

Në vazhdim ai tha se zyrtari i cili e ka pranuar aplikacionin për patentë shofer, pasi e ka pranuar e ka hedhur në shportë dhe se pas një diskutimi verbal, ai është arsyetuar që nuk e ka kuptuar atë. Për këtë arsye ai tha se nuk pajtohem se nuk ka bashkëpunim mes qytetarëve serb dhe policisë, pasi shumë qytetarë serb janë pjesëtarë të saj, por duhet identifikuar ato raste të cilët sillen në mënyrë diskriminuese, gjithashtu shtoi se qytetarët serb duhet ti drejtohen Inspektoratit Policor të Kosovës. Në mbyllje ai tha se vetëm një profesionalizëm i Policisë së Kosovës do të bënte që të arrihej një mirëbesim.

Kryetari i Komisionit- Për këtë çështje, ai tha se në mënyrë që mos të bëhet dukuri, çdo rast individual për raportet mes policisë dhe qytetarëve duhet të paraqiten pran Inspektoratit Policor dhe se procesi i tillë mund të mbikëqyret nga Komisioni, në mënyrë që mos të bëhen përgjithësime.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi